

Përmet, më 23-09-2019

FTESË PËR OFERTË

Lënda: Realizimi dhe vendosja e tabelave me informacion turistik në Bashkinë Përmet.

Projekti: “Iniciativa për Zhvillimin e Turizmit të Qëndrueshëm në Bashkinë Përmet”

Përshkrimi i projektit:

Projekti “Iniciativa për Zhvillimin e Turizmit të Qëndrueshëm në Bashkinë Përmet” zbatohet ngashoqata “Vjosa Explorer” dhe financohet nga Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor - ReLOaD. Projekti ka si qëllim promovimin e turizmit të qëndrueshëm si një fushë e rëndësishme për zhvillimin ekonomik dhe rritjen e cilësisë së jetës së banorëve të kësaj treve. Fokusi kryesor është të mbajë gjallë kulturën, historinë dhe traditën e pasur të zonës duke e përcjellë atë tek brezat më të rinj dhe të rrisë ndërgjegjësimin dhe edukimin në mbrojtjen e natyrës dhe mjedisit si elementë të rëndësishëm të zhvillimit turistik të zonës. Grupet e synuara të projektit janë të rinjtë e shkollave dhe të gjithë prodhuesit dhe ofruesit e shërbimeve turistike si artizanët, prodhuesit e produkteve tipike lokale, hotelet e restorantet e zonës, guidat turistike etj si dhe anëtarët e komunitetit të bashkisë në tërësi që janë të ndjeshëm për të rritur e promovuar turizmin nga njëra anë dhe ruajtjen e mjedisit dhe natyrës nga ana tjetër.

“Vjosa Explorer” është një organizatë jo-fitimprurëse e cilaka si qëllim zbatimin e politikave shtetërore dhe kombëtare në fushën e turizmit; promovimin dhe krijimi i identitetit të turizmit alternativ nëpërmjet shfrytëzimit të gjithë potencialit ekzistues turistik të vendit; zhvillimin rural si një potencial i madh për rritjen e cilësisë së jetës së komunitetit.

Përshkrimi i shërbimit që kërkohet:

“Vjosa Explorer” në kuadër të projektit “Iniciativa për Zhvillimin e Turizmit të Qëndrueshëm në Bashkinë Përmet”, është e interesuar të kontraktojë shërbimin e realizimit dhe vendosjes së tabelave turistike në atraksionet turistike të Bashkisë Përmet, si pjesë e aktiviteteve të këtij projekti.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TE KERKUARA



Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian



Empowered lives.
Resilient nations.

*Programi Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor – ReLOaD financohet nga
Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET



	Kërkohet
Formati:	Realizimi i tabelave me informacion turistik dhe vendosja e tyre në pikat turistike brenda qytetit dhe zonat rurale. Tabelat do të përmbajnë informacion turistik për pikën turistike përkatëse në dy gjuhë (shqip+anglisht). Dimensionet e tyre do të jenë në varësi të destinacionit dhe informacionit që do të përmbajnë. Tabelat do të ndërtohen me material cilësor dhe rezistent ndaj kushteve atmosferike.
Sasia:	Do të realizohen 10 tabela me informacion turistik.

Kushtet e ofertës

- Oferta duhet të shprehet në Lek.
- Subjekti duhet të lëshojë faturë të rregullt tatimore.
- Çmimi i ofertës duhet të përfshijë të gjitha kostot që lidhen me realizimin e shërbimit si dhe detyrimet tatimore kundrejt shtetit.
- Çmimi i ofertës përbën shifrën totale dhe mbetet i pandryshuar gjatë realizimit të shërbimit.
- Pagesa për shërbimin do të realizohet vetëm nëpërmjet transfertës bankare.

Vlerësimi i ofertave do të mbështetet duke pasur si referencë kryesore përmbushjen e specifikimeve teknike dhe çmimin më të ulët.

Preferohen subjekte që kryejnë aktivitetin në Bashkinë Përmet.

Të gjithë kandidatët e interesuar (subjekte të licensuar) duhet të dërgojnë dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

- Ftesa për ofertë plotësuar
- Kopje e licensës së subjektit (NIPT)

Dokumentacioni i Ofertës do të dorëzohet nëpërmjet postës ose i skanuar nëpërmjet e-mail, jo më vonë se data 03 Tetor 2019, në adresën e mëposhtme:

Adresa e dorëzimit të ofertës:

Shoqata “Vjosa Explorer”, Lagjia “Bajame”, Rruga “Kongresi i Përmetit”, nr. 31, sh. 6, Kati II, 6401, Përmet, Shqipëri.

vjosa.explorer@gmail.com

MIRËPRESIM OFERTEN TUAJ



Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian



Empowered lives.
Resilient nations.

Programi Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor – ReLOaD financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET



OFERTA

Emri i Subjektit _____

NIPT _____

Adresa _____

Çmimi i ofruar për realizimin dhe vendosjen e Tabelave me Informacion Turistik në Bashkinë Përmet është:

Përshkrimi i produktit	Sasia (cop)	Çmimi për njësi në LEK (TVSH e përfshirë)	Çmimi total në LEK (TVSH e përfshirë)
Realizimi dhe vendosja e tabelave me informacion turistik në Bashkinë Përmet	10		

Data e ofertës ___/___/___

Firma/Vula _____



Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian



Empowered lives.
Resilient nations.

Programi Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor – ReLOaD financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).